

## UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

**October 18-20** | **58. Symposium Einkauf und Logistik**

**October 25-26** | **Supplier Balkan Expo-SUBEX Skopje**

### Director's Note:

**Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,**

OEGJK gjatë kësaj jave ka qenë aktive jo vetëm në Kosovë, por dhe në Gjermani e rajon për të promovuar punën e Odës, anëtarësinë dhe për të krijuar lidhje të reja me tregun gjerman.

Gjithashtu, jemi rritur për 18 kompani të reja anëtare, ku shumica janë kompani gjermane që kanë filluar të operojnë në Kosovë!

**Dear members of the German-Kosovar Business Association,**

During this week, KDWV has been active not only in Kosovo but also in Germany and the region to promote the Chamber's work, membership, and to establish new connections with the German market.

Additionally, membership has grown by 18 new member companies, the majority of which are German companies that have started operating in Kosovo!

### 18 kompani të reja anëtarësohen në OEGJK

Bordi i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare ka mbajtur Mbledhjen e 49-të, më 5 tetor 2023. Përgjatë diskutimeve në rendin e ditës, u aprovuan edhe 18 kompani të reja anëtare.

Përveç kompanive kosovare, jemi krenar që anëtarësisë ju kanë bashkangjitur dhe investimet më të reja gjermane!

Më poshtë gjeni listen e plotë të anëtarëve të rinj të OEGJK-së:

- LIDL Kosova,
- Notus Energy Kosovo LLC
- STS Steuerungstechnik GmbH
- Benimussa Group shpk
- R&E Consulting
- ROLU service shpk
- Zilonis
- Numarics
- Happy shpk
- Haxhimustafa Architecture
- Labinot Agusholli BI - "Agusholli"
- Dukagjin solar service OA LLC

### 18 New Companies Join KDWV

The board of the German-Kosovar Business Association held its 49<sup>th</sup> Board Meeting on October 5<sup>th</sup>, 2023. During the discussions on the agenda, 18 new member companies were also approved.

In addition to Kosovo-based companies, there are also some well-known German companies among the new members.

Below is the full list of the new KDWV members:

- LIDL Kosovo,
- Notus Energy Kosovo LLC
- STS Steuerungstechnik GmbH
- Benimussa Group shpk
- R&E Consulting
- ROLU service shpk
- Zilonis
- Numarics
- Happy shpk
- Haxhimustafa Architecture
- Labinot Agusholli BI - "Agusholli"
- Dukagjin solar service OA LLC



- IDS KS SHPK
  - Ginza
  - Sierra Lab
  - Deutschzentrum Kosovo LLC.
  - KOS Strap
  - Manpower LTD
- IDS KS SHPK
  - Ginza
  - Sierra Lab
  - Deutschzentrum Kosovo LLC.
  - KOS Strap
  - Manpower LTD



**Fotografi nga Mbedhja e 49-të e Bordit të Odës Ekonomike Gjermano - Kosovare**

**Photo from the 49<sup>th</sup> Board Meeting of the German - Kosovar Business Association**

### **Përfaqësim i suksesshëm i bizneseve kosovare dhe OEGJK-së në BME**

Më 12 tetor, në Köln janë duke u zhvilluar takime biznes me biznes ndërmjet blerësve industrialë gjermanë dhe kompanive prodhuese nga Ballkani Perëndimor.

### **Successful Representation of Kosovar Businesses and KD WV at BME**

On October 12<sup>th</sup>, business-to-business meetings are taking place in Cologne between German industrial buyers and manufacturing companies from the Western Balkans.



Interesimi i kompanive gjermane për t'u furnizuar në vendet e Ballkanit Perëndimor është rritur dukshëm që nga koha e pandemisë dhe së fundi duke marrë parasysh sfidat me të cilat ballafaqohen kompanitë në zinxhirët e tyre të furnizimit për shkak të zhvillimeve të fundit gjeopolitike.

Për herë të 9-të, Ministria Federale e Ekonomisë dhe Mbrojtjes së Klimës e Gjermanisë (BMWK) bashkë me Asociacionin për Menaxhimin e Zinxhirit të Furnizimit (BME) organizojnë në bashkëpunim me rrjetin e Odave Ekonomike Gjermane në vendet e Ballkanit Perëndimor Konferencën me karakter B2B (biznes me biznes) "Iniciativa e Blerjeve në Rajonin e Ballkanit Perëndimor".

Delegacionin kosovar është duke u kryesuar nga Besarta Hyseni, udhëheqëse e Departamentit për Hyrje në Treg në Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare.

"Nearshoring është temë shumë aktuale. Ne si OEGJK përpiqemi të krijojmë sa më shumë mundësi për kompanitë vendore që të rrisin eksportin për në Gjermani. Jemi të lumtur që anëtarët e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, firmat Automatiks, Monting dhe Forma janë përzgjedhur për këto takime në Köln - kjo dëshmon se produktet kosovare kanë cilësi të lartë", thekson Besarta Hyseni, e cila ka shtuar se janë mbajtur 19 takime nga bizneset kosovare.

Nisma për zhvillimin e kësaj konference është marrë në 2014, si pjesë e procesit të Berlinit. Që nga edicioni i parë e deri më sot janë zhvilluar mbi 3,500 takime mes blerësve gjermanë dhe furnitorëve nga Ballkani Perëndimor.

"Potenciali në tregjet e Ballkanit Perëndimor vazhdon të jetë shumë i madh. Me këtë iniciativë, ne jo vetëm paraqesim shanse, por ndihmojmë të gjitha palët në ballafaqimin me sfidat e tanishme," thekson Olaf Holzgreffe, Drejtori për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Asociacionin për Menaxhimin e Zinxhirit të Furnizimit (BME).

The interest of German companies in supplying the Western Balkan countries has increased significantly since the time of the pandemic, given the recent geopolitical developments in their supply chains.

For the 9th time, the Federal Ministry for Economic Affairs and Climate Protection of Germany (BMWK) in collaboration with the Association for Supply Chain Management (BME) and the network of German Chambers of Commerce in the Western Balkans is organizing the B2B "Procurement Initiative in the Western Balkans" conference.

The Kosovar delegation is led by Besarta Hyseni, Head of the Market Entry Department at the German-Kosovar Business Association.

"Nearshoring is a very current topic. We, as KD WV, aim to create as many opportunities as possible for local companies to increase their exports to Germany. We are pleased that KD WV members Automatiks, Monting, and Forma have been selected for these meetings in Cologne - this demonstrates that Kosovar products are of high quality," says Besarta Hyseni, adding that they have held 19 meetings with Kosovar businesses.

The initiative for this conference was taken in 2014 as part of the Berlin Process. Since the first edition until now, more than 3,500 meetings have taken place between German buyers and suppliers from the Western Balkans.

"The potential in the markets of the Western Balkans remains significant. With this initiative, we not only present opportunities but also help all parties deal with current challenges," says Olaf Holzgreffe, Director of International Relations at the Association for Supply Chain Management (BME).

Participating companies are from Kosovo, Serbia, Croatia, Slovenia, Bosnia and Herzegovina, North Macedonia, Montenegro, and Albania.



Kompanitë pjesëmarrëse janë nga Kosova, Serbia, Kroacia, Sllovenia, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Shqipëri.



### **Drejtoresha Nora Hasani mori pjesë si paneliste në Core Days 2023**

Drejtoresha menaxhuese e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovareka marrë pjesë në konferencën "Core Days 2023: Growing Smart and Green: Local, Regional, European" që u mbajt në Kotor të Malit të Zi.

"ESG në Fokus: Ndikimi në bizneset e WB6 dhe hapat përpara" ishte tema e diskutimit në panelin, të cilin znj. Hasani e ndante me Sh.T. Giles Norman, ambasador i Kanadasë në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe Mal të Zi, Albana Laknorin, sekretare gjenerale e Odës Ekonomike dhe Industriale të Tiranës, Jovan Protić, përfaqësues i International Labor Organization në Serbi, Vladislav Cvetković, drejtor i Business Consulting në PwC dhe Đorđe Popović, drejtor i Resalta.


Drejtoresha Hasani tregoi përvojat e mira që ka hasur OEGJK tek anëtarët e saj në aplikimin e ESG-s, teksa shtoi se si odë kanë një sërë aktivitete që lidhen direkt me ESG, duke nënvizuar edhe prodhimin e një "paper" pikërisht për ESG. Ajo gjithashtu ka treguar për përgatitjen e kompanive anëtare në përshtatje me Ligjin gjerman për Zinxhirin e Furnizimit.

### **KDWV-Director Nora Hasani Participated as a Panelist at Core Days 2023**

The Managing Director of the German-Kosovar Business Association has participated in the conference "Core Days 2023: Growing Smart and Green: Local, Regional, European" held in Kotor, Montenegro.

"ESG in Focus: Impact on WB6 Businesses and the Way Forward" was the theme of the panel discussion, which Ms. Hasani was a part of with H.E. Giles Norman, Ambassador of Canada to Serbia, North Macedonia, and Montenegro, Albana Laknori, Secretary General of the Economic and Industrial Chamber of Tirana, Jovan Protić, representative of the International Labor Organization in Serbia, Vladislav Cvetković, Director of Business Consulting at PwC, and Đorđe Popović, Director of Resalta.

Director Hasani shared the positive experiences KDWV has had with its members in implementing ESG, emphasizing that the chamber has a range of activities directly related to ESG, including producing a "paper" specifically on ESG. She also discussed the preparation of member companies in compliance with the German Supply Chain Due Diligence Act.



## **Pjesëmarrja e përfaqësuesve të OEGJK-së në evente**

Përfaqësues nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare kanë marrë pjesë në disa organizime, në të cilat kanë qenë të ftuar.

Në **seminarin tre ditor lidhur me Kornizat e Integruara Kombëtare të Financimit (INFF)**, që u organizua nga Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në bashkëpunim me UNDP, mori pjesë Elena Elshani. Më pas në konferencën një-ditore: **"Dita e Konkurrencës 2023: Përfitimet e konkurrencës së drejtë në Kosovë"**, organizuar nga Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës, mori pjesë Gonxhe Abazi, e cila gjithashtu ishte edhe në **ceremoninë për 1-vjetorin e Gjykatës Komerciale**.

Në ngjarjen përmbyllëse të projektit **"Komponenta gjinore në promovimin e punës së denjë përmes menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë"** nga UN Woman ishte Eriola Muhaxhiri, teksa Greta Kazia mori pjesë në **Boost x Kosovo 2 Acceleration Program: NextGen**, nën organizimin e UNDP.

## **Participation of KDWV Representatives in Events**

Representatives from the German-Kosovar Business Association have participated in various events to which they were invited.

At a **three-day seminar on Integrated National Financing Frameworks (INFF)**, organized by the Strategic Planning Office in collaboration with UNDP, Elena Elshani participated. Later, at the one-day conference **"Competition Day 2023: The Benefits of Fair Competition in Kosovo,"** organized by the Competition Authority of the Republic of Kosovo, Gonxhe Abazi took part, and she also attended the **1st-anniversary ceremony of the Commercial Court**.

As for the concluding event of the **"Gender Component in Promoting Decent Work through Occupational Safety and Health Management"** project by UN Women, Eriola Muhaxhiri represented KDWV, while Greta Kazia participated in the **Boost x Kosovo 2 Acceleration Program: NextGen**, organized by UNDP.

## **HL - 3P Logistics me çmime të favorshme në shërbimet e transportit parcial të mallrave për gjithë Evropën**

Në një botë të njohur për zhvillimin e shpejtë ekonomik dhe tregtinë ndërkombëtare, logjistika është bërë një faktor kyç për suksesin e çdo kompanie. Në këtë kontekst, "3P Logistics - DHL" është një emër që ngritet si një zgjedhje e preferuar për transportin rrugor të pjesshëm në gjithë Evropën.

3P Logistics, përveç se është partneri zyrtar i DHL Express për Kosovë, njihet gjithashtu si një kompani logjistike e specializuar në ofrimin e shërbimeve të transportit rrugor të pjesshëm në të gjithë Evropën.

Një nga pikat më të forta të kësaj kompanie është angazhimi i saj ndaj cilësisë dhe efikasitetit në të gjitha nivelet e shërbimit të saj. Me një infrastrukturë moderne dhe një flotë të specializuar të mjetëve të transportit, 3P Logistics ka arritur të bëjë transportin rrugor të pjesshëm më të lirë, më të lehtë dhe më të sigurt për të gjithë eksportuesit dhe importuesit në Kosovë.

Tani, të gjitha kompanitë në Kosovë mund të planifikojnë transportet e mallrave të tyre me kohë, pasi që "3P Logistics" ofron transport të rregullt çdo ditë nga Kosova në të gjithë Evropën dhe në anën tjetër.

Ajo çka është më e atraktive janë çmimet shumë të përballueshme që fillojnë nga 99.00 euro për paletë. Ky çmim i favorshëm është i mundur falë strategjisë së re të kësaj kompanie në planifikimin dhe përdorimin efikas të burimeve logjistike.

Për ata që kërkojnë një partner të besueshëm në fushën e logjistikës, "3P Logistics - DHL" është një emër që duhet të konsiderohet.

Për të mësuar më shumë rreth shërbimeve të transportit parcial dhe ofertave, ju mund të kontaktoni në telefon: +38345500476 dhe email: [sales@3plog.net](mailto:sales@3plog.net)

## **HL - 3P Logistics Offers Favorable Prices for Partial Freight Services Across Europe**

In a world known for rapid economic development and international trade, logistics has become a key factor for the success of any company. In this context, "3P Logistics - DHL" is a name that stands out as a preferred choice for partial road transport across Europe.

3P Logistics, in addition to being the official partner of DHL Express for Kosovo, is also recognized as a specialized logistics company offering partial road transport services across Europe.

One of the strengths of this company is its commitment to quality and efficiency at all levels of its service. With a modern infrastructure and a specialized fleet of transport vehicles, 3P Logistics has made partial road transport more affordable, easier, and safer for all exporters and importers in Kosovo.

Now, all companies in Kosovo can plan their cargo shipments in advance, as "3P Logistics" offers regular transportation every day from Kosovo to all of Europe and vice versa.

What makes it even more attractive are the highly competitive prices starting from 99.00 euros per pallet. This favorable price is made possible through the company's new strategy in planning and efficiently utilizing its logistic resources.

For those seeking a reliable partner in the field of logistics, "3P Logistics - DHL" is a name worth considering.

To learn more about partial freight transport services and offers, you can contact them at phone: +38345500476 and e-mail: [sales@3plog.net](mailto:sales@3plog.net)



**KDWV-OEGJK**

Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung  
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

**NEWSLETTER** | OCTOBER 13th, 2023





**YOUR CONTACT PERSONS AT KDWW**

**BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWW-OEGJK:**

ICON Tower, 9th Floor, "Bekim Fehmiu" Str., no. 110; 10000 Prishtina

Monday - Friday | 8.30 - 16.30



**Greta Kazia**

HR, Përgjegjëse për Financa dhe Anëtarësi

HR, Responsible for Finance and Membership

[greta.kazia@oegjk.org](mailto:greta.kazia@oegjk.org)



**Besarta Hyseni**

Udhëheqëse e Departamentit mbështetje dhe shërbime të anëtarëve  
Këshilltare për Arsim Profesional Dual

Head of Market Entry & Events  
Advisor for VET

[besarta.hyseni@oegjk.org](mailto:besarta.hyseni@oegjk.org)



**Elena Elshani**

Asistente Ekzekutive  
Përfaqësuese për Shërbimin e Ekspertëve Seniorë (SES)

Executive Assistant  
Senior Expert Service Representative (SES)

[elena.elshani@oegjk.org](mailto:elena.elshani@oegjk.org)



**Gonxhe Abazi**

Zyrtare për Këshillim Ligjor

Legal Officer

[gonxhe.abazi@oegjk.org](mailto:gonxhe.abazi@oegjk.org)



**Eriola Muhaxhiri**

Koordinatorë / Coordinator

[eriola.muhaxhiri@oegjk.org](mailto:eriola.muhaxhiri@oegjk.org)